



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 930/2 Prot.

Tiranë, më, 16.04.2024

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion dhe vënie në dispozicion të vendimit

Z. J B

Të dhënat e kontaktit, e-mail: @gmail.com

I nderuar z. ,

Në përgjigje të kërkesës suaj drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në postën elektronike të koordinatores për të drejtën e informimit dhe medias, datë 2.04.2024, protokolluar me tonën nr. 930 prot., datë 02.04.2024, ju informojmë se:

Bazuar në nenin 4, pika 7 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 17, pika 6 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ju vemë në dispozicion faqet 73-77 të vendimit nr. 664, datë 24.05.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pjesërisht të paanonimizuar, referuar objektit të kërkesës suaj, që kanë të bëjë specifikisht me citimin e të dhënave tuaja dhe të përmbajtjes së denoncimit të kryer nga ju për subjektin e rivlerësimit P H , pjesë e vendimit të arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i KPK-së.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I/PËRGJITHSHËM

